

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet ,parametrat teknike etj :

Specifikimet e punimeve te mirmbajtjes:

Per punimet e mirmbajtjes ne objektet e institucionit ,firma fituese duhet te kete parasysh dhe te zbattoj keto specifikime punimesh dhe materialesh :

Suvatimi i Mureve :

suvatimi i mureve te behet sipas KTZ me tre duar.

-Spruco me llac cemento 1:2 me fasho

-Mbushje me llac bastard M30 ; Fino

Ne vendet ku fasada eshte e demtuar eshte llogaritur qe te behet cukitje dhe suvatim me fino.

Suvatimi i brendshem ne riparime.

Sistemim i siperfaqeve ku eshte e nevojshme per suvatime per nivelimet e parregullsive me ane te mbushjes me llac bastard me me shume shtresa dhe copa tullash neqoftese eshte e nevojshme edhe per zonat e vogla si dhe cdo detyrim tjeter per ta perfunduar plotesisht stukimin.

Perpara se te hidhet sprucimi duhet qe siperfaqja qe do te suvatohet te laget mire me uji.Sprucimi i mureve dhe tavaneve per muratur te pastrar me llac cimentoje te lenget per permirsimin e ngjitjes se suvase dhe rforcimin e siperfaqeve te muratures, duke perfshire skelat e sherbimit dhe cdo detyrim tjeter per ta perfunduar plotesisht sprucimin.

Suvatim me drejtues i realizuar nga nje shtrese me trashesi 2cm llac bastard m-25 me permbajtje per m²; rere e lare 0.005m³;llac gelqereje m-1:2.0.03m³;cemento M400;6.6kg;uji.i aplikuar me paravendosje te drejtueseve ne mure(shirit me llac me trashesi 15cm cdo 1 deri 1.5 ml dhe e lemuar me mistri e berdaf ,duke perfshire skelat e sherbimit si dhe cdo detyrim tjeter per ta perfunduar plotesisht suvatimin.

Suvatim i Jashtem me riparime ;

Stukim e sistemim i siperfaqeve ku eshte e nevojshme per suvatime per nivelimet e parregullsive me ane te mbushjes me llac bastard me me shume shtresa dhe copa tullash nqse eshte e nevojshme edhe per zonat e vogla si dhe cdo detyrim tjeter per te perfunduar plotesisht stukimin.

Perpara se te hidhet sprucimi duhet qe siperfaqja qe do te suvatohet te laget mire me uji.Sprucimi i mureve dhe tavaneve per muratur te pastruar me llac cimentoje te lenget per permiresimin e ngjitjes se suvase dhe rforcimin e siperfaqeve te muratures ,duke perfshire skelat e sherbimet dhe cdo detyrim tjeter per te perfunduar plotesisht sprucimin.

Suvatim i realizuar nga nje shtres me trashesi 2cm llaci bastard m-25 me dozim per m² rere e lare 0.005m³,llac bastard0.03m³,cemento 400 7.7kg,uji.I aplikuar me paravendosje te drejtuesve ne mure 9shirit me llac me trashesi 15cm cdo 1 deri 1.5 m) dhe e lemuar me mistri,duke perfshir skelat e sherbimit si dhe cdo detyrim tjeter per ta perfunduar plotesisht suvatimin

Bojatisja me hidromat :

Para fillimit te lyerjes ,kontraktori duhet ti paraqese per aprovim ndjeksit te punimeve :marken,cilesine dhe katalogun e ngjyrave te bojes qe ai mendon te perdore.Personeli qe do te kryej lyerjen te jete me eksperienc ne ate fushe dhe duhet te zbatoje te gjitha kushtet teknike te lyerjes sipas KTZ dhe STAZH.Bojatisja me hidromat te behet me dy duar,me ngjyra me pikment sipas standarteve te shkollave.

Lyerja me boje plastike ne godine:

Lyerje me boje plastike e siperfaqeve te brendshme

1.Pregatitja e siperfaqes qe do te lyhet :

Para lysterjes duhet te behet pastrimi i siperfaqes se murit me ane te stukimit me material sintetik dhe berja gati per paralysterje.Ne rastet e siperfaqeve te patinuara behet nje pastrim i kujdesshem i siperfaqes.

Para fillimit te procesit te lysterjes duhet te behet mbrojtja e siperfaqeve qe nuk do te lyhen(dyer,dritare etj) me ane te vendosjes se letrave mbrojtese.

2.Paralysterja e siperfaqes se brendshme te pastruar :

Ne fillim te procesit te lysterjes behet paralysterja e siperfaqeve te pastruara mire me vinovil te holluar (Astar plastik).Per paralysterjen behet perzierja e 1 kg vinovil me 2.5—3 litra uji.Me perzierjen e pregatitur behet paralysterja e siperfaqes vetem me nje dore.

Norma e perdorimit eshte 1 liter perzierje vinovil me uji,duhet te perdoret per 20 m² siperfaqe.

3.Lysterja me boje hidromat e siperfaqes.

Ne fillim behet pregatitja e perzierjes se bojes hidromet te lenget e cila eshte e paketuar ne kuti 5 – 15 litershe.Lengu i bojes hollohet me uji ne masen 20—30%.Kesaj perzierje i hidhet pigmenti deri sa te merret ngjyra e deshruar dhe e aprovuar nga supervizori i punimeve dhe pastaj behet lysterja e siperfaqes.Lysterja behet me dy duar.

Norma e perdorimit eshte 1 liter boje hidromat i holluar duhet te perdoret per 2.7 – 3 m² siperfaqe.Kjo norme varet nga ashpersia e siperfaqes dhe lloji i bojes se meparshme.

Ne ndertime te reja para lysterjes duhet te behet pastrimi i siperfaqes qe do te lyhet nga pluhurat dhe te shikohen demtimet e vogla te saj,te behet mbushja e gropave te vogla apo demtimeve te siperfaqes se murit me ane te stukimit me material sintetik dhe berja gati per lysterje.

Para Lysterjes duhet te behet mbrojtja e siperfaqeve qe nuk do te lyhen(dyer,dritare etj)me ane te vendosjes se letrave mbrojtese.

Ne fillim te procesit te lysterjes behet paralysterja e siperfaqeve te pastruara mire me gelqere te holluar (Astar)Ne fillim behet pregatitja e astarit duke perzier 1 kg gelqere me 1 liter uji.Me perzierjen e pregatitur behet paralysterja e siperfaqes me nje dore.

Norma e perdorimit eshte : 1 liter gelqere e holluar duhet te perdoret me 2 m² siperfaqe.Me pas vazhdohet me lysterjen me boje si me poshte :

- Behet pergatitja e perzierjes se bojes hidromat te lengshem me uji.Lengu i bojes hollohet me uji ne masen 20—30%.Kesaj perzierje i hidhet pikment derisa te merret ngjyra e deshruar.
- Behet lysterja e siperfaqes.Lysterja behet me dy duar.Norma e perdorimit eshte : 1 liter boje hidromat i holluar ne 2.7—3 m² siperfaqe.(ne varesi te ashpersis se siperfaqes se lyster.)

Lysterje me boje vaji rikonstrukcion

Perpara bojatisjes ,behet gerryerja dhe heqja e lysterjeve te vjetra nga siperfaqet.Kjo realizohet me shume shtresa mbi dyer dhe dritare prej druri,mbi punimet ekzistuese si dhe siperfaqe hekuri me solvent,me dore ose me paisje te mekanizuara ,duke perfshir skelat e sherbimit ose skelerin si dhe levizja ne ambientin e kantierit.

Stukim dhe zmerilim te elementeve prej hekuri ,duke perdorur stuko te pershtatshme per pregatitjen e siperfaqeve per lysterje me boje vaji.

Lysterje e elementeve prej hekuri,fillimisht me boje te pregatitur me nje dore minie plumbi ose antiruxho ose ne formen e vajit sintetik me permbajtje per m² 0.08 kg.

Lyerje me boji vaji sindetik per siperafe metalike me dozim per m2 :boji vaji 0,2 kg dhe me shume duar.per te pasur nje mbulim te plot dhe perfekt te siperafeve si dhe cdo gje te nevojshme per mbarimin e plot te lyerjes me boji vaji.

Hidroizolim Tarace :

Rikonstrukcion i demtimeve te pjeseve te pjerrta,duke perdorur llac cemento me permbajtje perzierje 1:2 sipas pikes 5.1.1.5,pas ketij riparimi do te formohet nje shtres k llac cementoje me trashesi minimumi 2cm te niveluar per krijimin e shtreses izoluese.

Punimi i siperafes vertikale i pregatitur per intalimin e membranave izoluese 2 leter trashesi 4mm.

Shtresa izoluese duhet shtrir ne nje siperafe te thate,te pastruar e niveluar mire me pare me shtres horizontale pjerrresi si dhe siperafe vertikale.Keto trajtohen fillimisht me nje shtres bituminoze dhe mbi keto fillon vendosja e fleteve bituminoze,me fiber minerale,sejcala me trashesi 4mm te ngjitura me ngrohje dhe ne menyre te tille qe fletet te mbivendosen njera tjetres ne siperafe te pjerrta ose vertikale,duke siguruar qe mbulesa e elementeve te bashkuara te jete minimumi 10cm.

Zevendesimi i parapeteve te hequra duke perfshire riparimet e nevojshme e zevendesim me pllaka te reja duke i fiksuar me llac cemento (tip 1:2) te ngjitura dhe te gjitha kerkesat qe taraca te riparohet me cilesi.

Punimet e Sistemit te Ngrohjes :

Duhet te jene te plota dhe materialet qe duhet te perdoren te jene prodhim i certifikuar sic jane te demtuarat.Para se te zevendesohen pjeset duhet te behen te qarta nga perfaqesuesit te

kontraktuesit qe jane origjinale dhe me pas te kryhet zevendesimi dhe te kryhet prova e tyre me ngarkes.Aktualishte Spitali Lushnje ka ne perdorim dy kaldaja me lend djegese „Solar“;me koka sprucatori Fi 35mm e Fi 50mm ;keto kaldaja ,jane ne pune ne Spitalin Lushnje ;qysh nga viti 1998 e ne vijim.Per mirmbajtjen e Kaldajave duhet specialist i licensuar ne kete fushe.

Punimet Hidraulike : i

Duhet te jene te plota ne te gjitha pikpamjet si ne montim ,ashtu dhe material ,te cilat do te realizohen ne bashkpunim me ndjeksin e punimeve.Montimi i paisjeve duhet te perfshije edhe furnizimin me uji per grupin e lavamanit dhe te WC.Materialet hidrosanitare te jene importi sipas standarteve per objekt.

WC dhe kasete e shkarkimit

Ne ambientet e larjes apo dhomat e tualetit parashikohet edhe vendosja e WC.Ato jane me material porcelani me te dhenat e standarteve teknike nderkombetare.ne shkolla rekomandohet te tipit oriental WC,ku vendoset direkt ne dysheme dhe montohet llac cemento sipas udhezimeve te dhena nga supervizori.

WC-ja duhet te siguroje perciellshmeri te lart te ujrave,rezistenc ndaj goditjes mekanike ,mbrojtese izoluese ndaj ujrave,rezistenc ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike,lehtesi gjate punes ne to dhe mundesi te thjeshta riparimi.

WC-ja lidhet me tubat e shkarkimit te ujrave me ane te tubit ne forme sifoni.tubi i lidhjes se Wc me tubat e shkarkimit duhet te jete PVC me te njejtat karakteristika

teknike te tubave te shkarkimit te ujerave. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te WC(FI 100)

WC-ja lidhet me sistemin e furnizimit me uji me ane te kasetes se shkarkimit e cila mund te instalohet direkt mbi WC ose ne mure e ndare nga WC-ja. Kjo varet nga lloji i ketyre paisjeve. Kaseta e shkarkimit vendoset ne lartesi rreth 1.5m lart nga dysHEMEJA(rasti kur eshte e ndare). Ajo mund te jete porcelani, metalike ose plastike. Lloji i materialit te saj duhet te percaktohet ne projekt. Tubi i shkarkimit fiksohet ne mure me fasheta te forta xingato, me vida dhe tapa me fileta ne cdo 50cm.

Ne kete ze perfshihet heqja e kasetave te demtuara nqese ka, vendosja dhe montimi i kasetave te WC dhe prova e saj me furnizim uji.

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e WC duhet te behen sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit. Bashkimi i WC me tubat e shkarkimit duhet te behet me mastik te pershtateshem per tuba PVC, i rekumanduar nga prodhuesi i tij.

Ne zerin : Mirmbajtje bordurave ,pjeses asfaltuar(rrugeve) ,K.U.Z ,Lulishtes etj brenda teritorit Spitalit jane parashikuar : Punime mirmbajtje bordurave (zevendesim bordure te demtuar, perforcim bazamentit bordurave, lysterje bordurave me gelqere), Punime mirmbajtje pjeses asfaltuar brenda teritorit spitalit si : mbushja e gropave me beton ,heqje mbeturinave me mjete ,furnizim me zhavor, granil etj ; Punime mirmbajtje KUZ brenda teritorit spitalit : Punime si : cbllokim pusetave me mjete mekanizuar ose me krah ; Punime mirmbajtje Lulishtes : parashikuar punime si : krasitje pemeve ,lyerje me gelqere pemeve etj.

Grafiku i Punimeve

Kontraktuesi duhet ti jape pergjegjesit/ndjeksit te autoritetit kontraktor nje program te plote duke i treguar rendin, proceduren dhe metoden sipas te cilave ai propozon te punohet deri ne mbarim te punes.

Menyra dhe rregulli qe jane propozuar per te ekzekutuar keto punime permanente eshte teme per tu rregulluar dhe aprovuar nga pergjegjesi i autoritetit kontraktor, dhe cmimi i kontrates duhet te jete i tille qe te perfshije cdo rregullim te nevojshem te kerkuar nga pergjegjesi i autoritetit kontraktor gjate zbatimit te punimeve.

Punime te Gabuara

Cdo pune qe nuk eshte ne perputhsje me keto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet te riparoj cdo difekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

Dorzimet te ndjeksi i punimeve, autorizimet me shkrim, rregullat me shkrim do ti referohen cdo dokumenti dhe letre te nenshkruar nga pergjegjesi i autoritetit kontraktor, te derguara kontraktuesit, qe permbajne instruksione, udhezime ose orientime per kontraktorin ne menyre qe ai te realizoje ekzekutimin e kesaj kontrate.

Fjalet e aprovuara, te drejtuara, te autorizuar, te kerkuara, te lejuara, te urdheruara, te instruara, te emeruar, te kosideruara te nevojshme, urdheresa ose jo (duke perfshire: emra, folje, mbiemra, dhe ndajfolje) te nje rendesie do te kuptohet qe aprovimet e

shkuara, drejtimet, autorizimet, kerkesat, lejet, rregullat, instruksionet, emerimet, urdheresat e Autoritetit kontraktor/Perfaqesuesit te autorizuar do te perdoren deri ne daljen e nje plani tjeter pune.

Specifikimi i Materialeve :

Pershkrimi i kerkesave te zbatimit te sherbimeve ne lidhje me to :

1. Grupi i Punes Argumentimit F.L Sqaron : Ne cmimin per njesi sherbimi te mirmbajtjes objekteve ndertimore dhe impiantistikes jane perfshire vlefta e punimeve : Shpenzime per heqjen e materialit te demtuar nga objekti ,Furnizim e Vendosje ne

objekte e materialit te ri (vlefa e materialit,puntori,shpenzimet e detyrimet tjera ligjore etj).

Dokumentat standarte te tenderit

Jane te domosdoshem per ecurin e punes se riparimit dhe mirmbajtjes ne Spitale ; specialistet e poshteshenuar :

. Murator ,Bojaxhi ,Specialit mirmbajtes kaldajava ngrohjes ,specialist mirmbajtes te frigorifereve,lavatriceve ,kondicionereve ,fotokopjeve,kompjutrave e printeve ne spitale , ,specialit marangos per mirmbajtjen e dyerve dhe dritareve objekteve ,fv.brava dyersh,xhama dritaresh ,doreza dyersh e dritaresh etj . Te gjithë punonjesit qe do te punojne si specialite pran Spitalit ne permbushjen e detyrimeve te kontrates se mirmbajtjes ;detyrimishte duhet te jene te licensuar dhe konfirmuara sipas legjislacionin shqiptar ne fuqi. Punonjest sipas specifikimeve te mirmbajtjes duhet te jene me kontrat pune nga operatori ekonomik qe futet ne kete procedur tenderimi.

Per asnje raste nuk do te pranohet te punoj si specialist per mirmbajtjen;neqoftese specialisti nuk eshte i kompletuar me licensen qe kerkohet ne DST e ketij Tenderimi.

Objekt i Mirmbajtjes : Do te jene te gjitha Godinat brenda teritorit te Spitalit Lushnje dhe Godina e Poliklinikes ne Qytetin Lushnje.

— SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT —

Shërbimi që kërkohet:

Riparimi dhe mirmbajtja e objekteve, impiantistikes se godinave dhe pajisjeve te zyrave, Sipas preventivit bashkelidhur

Punime te tilla si :

Riparim i kaldajes,riparim lavatrice,riparim fotokopje,kondicioner,do te kerkohet paisje me flete garancie per gjashte muaj.

Hidroizolim do te kerkohet paisje me flete garancie per nje vite.

Afatet e ekzekutimit:

Fillon menjehere me nenshkrimin e kontrates dhe perfundon me 31.12.2017

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Riparimi dhe mirmbajtja e objekteve ndertimore,impiantistikes se godinave dhe pajisjeve te zyrave

Detyrat:

Kontraktuesi duhet te jete i gatshem te kryej sherbimin sipas parshikimeve ne preventive. Sherbimi do te kryhet jo vetem brenda orarit zyrtar por, per ato qe jane emergjente edhe jashte orarit zyrtar.

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Spitali Ihsan Çabej Lushnje

